



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**

**PROKURORIA THEMELORE**

**Zyra e Kryeprokurorit**

**AD.nr.3/2024**

**Më datë: 13 Dhjetor 2024**

**Gjilan**

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan si autoritet kompetent, merr këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET**, ankesa e paraqitur nga [REDACTED] se hetimi në lëndën PP.II.nr. [REDACTED], nga Prokuroria Themelore në Gjilan, nuk ka qenë i drejtë dhe objektiv.

**A r s y e t i m i**

Më datë 14 Nëntor 2024, kemi pranuar ankesën e palës ankuese [REDACTED] me pretendim se Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë ngritjes së aktakuzës me numër PP.II.nr. [REDACTED] të datës 23.07.2024, kualifikimin e veprës penale e ka bërë në favor të të pandehurit, e nga ky kualifikim ka rezultuar më dënim me gjobë.

Më datë 20 Nëntor 2024, konform nenit 9 par. 5 të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, për pranimin e ankesës nga [REDACTED]

Ankuesja [REDACTED] në ankesën e saj pretendon se Prokuroria Themelore në Gjilan, lëndën me numër PP.II.[REDACTED] e ka proceduar në Gjykatë me aktakuzë për shkak të veprës penale ngacmimi nga nenin 182 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, e jo për shkak veprës penale ngacmimi nga nenin 182 par. 4 lidhur me par.1 të KPRK-së, e si rrjedhojë e kësaj ndaj të pandehurit ka pasur dënim me gjobë, e që këtë dënim e konsideron shumë favorizues ndaj të pandehurit dhe njëkohësisht shumë ofensive e ndaj viktimës.

Pas pranimit dhe analizimit të ankesës të paraqitur nga ana e ankueses [REDACTED] me qëllim të verifikimit të këtij dyshimi, kemi kërkuar shkresat e lëndës PP.II.nr.[REDACTED] dhe pas vlerësimit të cilave kemi konstatuar këtë gjendje:

Më datë 17. Korrik 2024, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka pranuar kallëzimin penal, me numër [REDACTED] të datës 07.Korrik 2024, kundër të pandehurit [REDACTED] për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprat penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së dhe Fotografimi dhe Incizimet tjera te paautorizuara nga neni 202 paragrafi 2 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjilan, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 paragrafi 2, nenit 235 të KPRK-së dhe në provat personale dhe materiale, ka paraqitur aktakuzën e drejtpërdrejtë për të pandehurin [REDACTED] në drejtim të veprës penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 i KPRK-së, ngase u vërtetua dyshimi i bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit konsumohen të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se pikërisht i njëjti është kryes sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës dhe se i njëjti edhe është penalisht përgjegjës, ndërsa sa i përket veprës penale Fotografimi dhe incizimet tjera te paautorizuara nga neni 202 paragrafi 2 të KPRK-së, nuk janë vërtetuar elementet e kësaj veprës penale.


Sa i përket veprës penale Ngacmim nga neni 182 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1 i KPRK, sa i përket kësaj dispozite, vepra penale mund të kryhet në dy situata. Situata e parë shprehet në rastet kur ndonjë person me sjelljen apo komunikimin e tij të vazhdueshëm, ka për qëllim që personin tjetër ta ngacmojë, ta frikësojë, të performojë më qëllim të lëndimit, të dëmtimit të pasurisë apo të vrasjes së personit tjetër, ose fëmijës së tij, anëtarit të familjes ose kafshës shtëpiake; b) Situata e dytë e kësaj vepre penale shprehet në rastet kur kryesi e vë tjetrin nën vëzhgim, e përcjellë me qëllim të ngacmimit, frikësimit, lëndimit, dëmtimit të pasurisë apo vrasjes së personit apo fëmijëve të tij, anëtarit të familjes, të afërmeve apo kafshës shtëpiake. Kjo situatë e kryerjes së kësaj vepre do të konsiderohet se ekziston nëse nga ky lloj vëzhgimi apo përcjellje, te personi tjetër shkaktohet frikë e arsyeshme se do të vritet, se do t'i shkaktohet lëndim i rëndë trupor, dëmtim i madh i pasurisë ose shqetësim i madh emocional. Nëse zbërthehet në tri komponentët kryesore e që janë të domosdoshme për ekzistimin e kësaj vepre penale dhe atë: veprimi, mënyrat dhe qëllimi, atëherë në rastin konkret gjendja e kësaj faktike u vërtetuar përmes këtyre provave: Rasti iniciuar me numër [REDACTED] të datës 07.Shkurt 2024,

deklarata e të dëmtuarës [REDACTED] deklarata e të pandehurit [REDACTED] raporti i zyrtarit policor, një GPS.

Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr. [REDACTED] të datës 06 Nëntor 2024, ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhrin ndëshkimor për të pandehurin [REDACTED] duke e shpall fajtor dhe dënuar më dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim i pandehuri është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit.

Pasi pala ankuese [REDACTED] ka pranuar aktgjykimin, e njëjta më datë 15 Nëntor 2024, ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, kthimin e çështjes në rigjykim, e që më datë 11 Dhjetor 2024, Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, ka mbajtur shqyrtimin fillestar, ku prezent kanë qenë prokurori i shteti, e dëmtuara dhe i pandehuri, e që në shqyrtimin fillestar, pasi prokurori ka lexuar aktakuzën, i pandehuri ka pranuar fajësinë, ndërsa e dëmtuara ka deklaruar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se do të paraqet kërkesë pasurore juridike, ndërsa prokurori ka mbetur pran aktakuzës, ashtu që pas përfundimit të shqyrtimit fillestar, meqë nuk ka pasur propozime, gjykata do të shpallë aktgjykimin.

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore dhe arsyet faktike të cilat u cekën më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kopje/njoftim konform nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve:

1x1 kopje z. [REDACTED]

1x1 kopje, ankuese [REDACTED]

1x1 kopje, arkivës.